



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 780/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Nusret Çubreli kandidat për kuvendin komunal në Mitrovicë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega Mitrovicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si i pabazuar apeli i parashtruar nga Nusret Çubreli kandidat për kuvendin komunal në Mitrovicë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega Mitrovicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpallje së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, me datën 09.11.2017 në ora 16:45, ka pranuar një apel nga Nusret Çubreli kandidat për kuvendin komunal në Mitrovicë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) thekson se i mungojnë votat në vendvotimet 1111B/01R/02R/04D në Bedri Gjina, 1101B/01R/03R/04D në Zhabar, 1103B/03R/04R/05R/06R/07D në Vaganicë, 1117B/01R në Shupkovicë, 1104/01R/02R/03R/04R/07R/08D shkolla Ismail Qemaili, 1102X/01R/02R/03R, /04R/06R/07R/010R/011R/012R/013R/015R/, 016D në shkollën Abdullah Shabani, 1102B/02R/05R/06R/07R/08R/09R/010R deri në 018RD në shkollën Migjeni, 1109B/02R/04D në shkollën Andon Zako Çajupi.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të provave, që gjenden në shkrësat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara pasi që parashtruesi i apelit nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me pretendimet e tij.

Parashtrimet në apel nuk paraqesin bazë ligjore për parregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimet e sipërcituara dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor për ankuesin .

Paneli vlerësoi se pretendimet në apel nuk janë të bazuara dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore të përcaktuara me dispozitat e nenit 10.7 pika c) të Rregullës së PZAP-it 02/2015 si dhe të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së.

Paneli, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete lidhur me pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pa argumentuar me fakte dhe si i tillë është i pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në mbështetje të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL Anr.780/2017 më datën 12.11.2017.

**Kryesuesja e Panelit
Gyltene Sylejmani**



***Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*